



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 29, datë 27.02.2025

PËR

“MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar (në mungesë)
2. Zotit Erind GERMENJI	Zv/Kryetar
3. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zotit Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
7. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
8. Zotit Vatë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 27.02.2025, konform procedurës së përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Mbarimin e statusit të magjistratit”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim, relacioni shoqërues nr. 393 prot., datë 26.02.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoji relatorin zotin Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

VËREN:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.
2. Pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është regjistruar kërkesa për dorëheqje nga detyra e zotit Arian Ndoja, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me nr. 345 prot, datë 24.02.2025. Kjo kërkesë është motivuar “për shkak të angazhimit në një aktivitet tjetër të papajtueshëm me funksionin e magjistratit”.
3. Zoti Arjan Ndoja është emëruar prokuror me Dekretin nr. 3474, datë 23.09.2002, si prokuror në stazh, në Prokurorinë e Rrethit Durrës. Aktualisht është pezulluar nga funksioni me vendimin nr. 528, datë 06.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Prokurori Arian Ndoja e ka mbështetur kërkesën në nenet 64, pika 1, germa “a” dhe 65 pika 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku përcaktohet:

“Neni 64

Kohëzgjatja në detyrë e magjistratit

1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur:

a) jep dorëheqjen;

b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji;

ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji;

d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë del në pension në moshën 70 vjeç. Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë i mbaron mandati kur mbush moshën 70 vjeç, pavarësisht nga vitet e ushtrimit të funksionit në këtë pozicion.

3. Prokurori i Përgjithshëm del në pension në moshën 70 vjeç. Prokurorit të Përgjithshëm i mbaron mandati kur mbush 70 vjeç, pavarësisht nga vitet e ushtrimit të funksionit në këtë pozicion.

4. Mandati i Prokurorit të Prokurorisë së Posaçme mbaron në fundin e muajit në të cilin mbush moshën 67 vjeç, pavarësisht viteve që ai ka qenë në detyrë në këtë pozicion.

5. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaron



me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.

6. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë deklarohet me vendim të Gjykatës së Lartë jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës. Mbarimi i mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe prokurorit të Prokurorisë së Posaçme deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.”

“Neni 65
Dorëheqja

1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur:

a) jep dorëheqjen;

2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.

3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

5. Nisur nga parashikimet ligjore të sipërpërmendura, është e evidentuar se, kërkesa e zotit Arjan Ndoja për deklarinimin e mbarimit të statusit, është administruar në Këshill me shkrim dhe është e motivuar, në këto kushte, Këshilli vlerëson të deklarojë me vendim mbarimin e statusit të magjistratit Arjan Ndoja, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për shkak dorëheqje. Dorëheqja ka efekt menjëherë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës, nenet 64 pika 1 germa “a” dhe 65 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a”, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe kërkesën për dorëheqje nga detyra të zotit Arjan Ndoja prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, regjistruar me nr. 345 prot, datë 24.02.2025, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak dorëheqje për zotin Arjan Ndoja me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Dorëheqja ka efekt menjëherë.

SEKRET

3. Të njoftohen për këtë vendim zoti Arjan Ndoja, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 27.02.2025



ZY/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Ledina Riza
(kundër)

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla